



Preportr

METODAT E MANGËTA TË VLERËSIMIT



Studentët në UP përgjithësisht vlerësohen vetëm me provimin final. Kjo po ndodh përkundër rregullimit statutor të UP-së ku parashihet vlerësim sistematik me metoda të ndryshme përgjatë vitit akademik. Njohësit e fushës së arsimit thonë se kjo po ndikon në cilësinë e studimeve, derisa në rektorat thonë se janë duke marrë masa që vlerësimi sistematik të zbatohet në të gjitha fakultetet e UP-së

Besnik Boletini, Leonida Molliqaj

Shumica e profesorëve në Universitetin e Prishtinës i vlerësojnë studentët vetëm përmes provimit final. Kjo mënyrë e vlerësimit nuk siguron angazhim të vazhdueshëm të studentëve në procesin mësimor përgjatë semestrit, përkatësisht vitit akademik.

Në bazë të Sistemit të Bolonjës, të cilin e zbaton UP-ja, vlerësimi duhet të bëhet në mënyrë sistematike duke përdorur metoda të ndryshme të cilat stimulojnë studentin të mësojë dhe në të njëjtën kohë u ndihmon edhe profesorëve të bëjnë vlerësime meritore.

Meqë UP-ja zbaton reformat e Sistemit të Bolonjës, ky institucion e ka paraparë edhe vlerësimin sistematik por në shumicën e fakulteteve kjo ka mbetur vetëm në letër.

Sipas nenit 108 të Statutit të UP-së, studentëve u garantohet vlerësim i vazhdueshëm përgjatë vitit akademik me forma të ndryshme të vlerësimit, duke i aplikuar këto metoda: provimi, kolokviumi, punimi seminarik, praktika profesionale, testi praktik gjatë

ushtrimeve, interpretimi dhe prezantimi i krijimtarisë artistike dhe i punëve të tjera.

Zbatimi i këtyre metodave bartet deri në syllabuse të lëndëve, por ato nuk zbatohen në praktikë. Pothuajse të gjitha departamentet e fakulteteve të UP-së i kanë të publikuara syllabuset për secilën lëndë dhe në kuadër të tyre përcaktohen qartë edhe metodat e vlerësimit. Por vetëm në disa fakultete dhe vetëm disa profesorë i zbatojnë këto metoda. Shumica e tyre vlerësimin e studentëve e bëjnë përmes provimit final.

Kjo metodë e mangët e vlerësimit po ashtu konsiderohet se e nxit edhe dukurinë e kopjimit. Fakti se kalimi ose rënia nga provimi përcaktohet në 45 minuta krijon prirje për të kopjuar dhe për ta “hequr qafe” atë provim. Në një hulumtim që e ka realizuar Preportr muaj më parë tregohet për metodat e ndryshme dhe thjeshtësinë e përgatitjes për kopjim.

Nëse vlerësimi do të bëhej në mënyrë sistematike,

angazhimi i studentëve për lëndët përkatëse do të ishte më i madh, dhe kësajsoji përvetësimi i dijes do të ishte më efikas.

Hysen Bytyqi, prorektor për zhvillim dhe cilësi në Universitetin e Prishtinës ka thënë për Preporfr se rektorati e ka bërë prioritet zbatimin e vlerësimit sistematik dhe tashmë u ka drejtuar nga një letër dekanëve të fakulteteve që të angazhohen në këtë drejtim.

“Ne të gjithë jemi të vetëdijshëm se sistemi i arsimit në bazë të Bolonjës kërkon disa sfida të tjera të cilat mund të them që jo të gjithë pedagogët kanë qenë të përgatitur ta absorbojnë një metodologji të re, një formë të re, një qasje të re ndaj studentit, ndaj vlerësimit, ndaj zhvillimit të strukturës së lëndës dhe implemtimit të lëndës në përgjithësi”, thotë Bytyqi.

Ai thotë se moszbatimi i syllabusëve, përkatësisht mungesa e vlerësimit sistematik të studentëve krijon pasoja të shumta për studentët. Bytyqi i cili është edhe profesor në Fakultetin e Bujqësisë, tregon se gjatë procesit të monitorimit, menaxhmenti i rektoratit ka identifikuar se për shumicën e studentëve kohëzgjatja e studimeve në UP duket të jetë më e madhe sesa që është paraparë në kuadër të Sistemit të Bolonjës.

“Kjo është mjaftueshëm indikacion të shohim, të kthehem mbrapa se çfarë është duke ndodhur me vlerësimin e studentëve. Kjo është një diçka që në procesin e ardhshëm nuk është me shumë alternativa. Ky është një proces që ne duhet ta implemtojmë dhe ta kalojmë. Unë jam i sigurtë se vlerësimi periodik do ta ndikojë në shkurtimin e kësaj kohëzgjatje dhe do të jetë një afat i përfundimit të studimeve shumë më real dhe afërisht i njëjtë me institucionet arsimore të nivelit të lartë në Evropë, kryesisht ku ne bazohemi shumë”, theksoi Bytyqi, duke shtuar se nëse punohet fuqishëm dhe implemtohen metodat e vlerësimit gjatë gjithë semestrit, do të evitohen shumë efekte të tjera të cilat nuk kanë rezultate pozitive si afatet e provimeve jashtë statutit, etj.

Prorektori Bytyqi thotë se një pjesë e profesorëve tashmë e implemtojnë vlerësimin e vazhdueshëm dhe kjo tregon se përveç se është e nevojshme, kjo është edhe e mundshme dhe do të insistohet në këtë aspekt.

“Asnjë profesor deri më tani nuk e ka kundërshtuar këtë formë të vlerësimit. Por zakonisht arsyet e tyre kanë një bazë, pasi që në fakultetet ku numri i studentëve është i madh, siç është Fakulteti Juridik, Fakulteti Ekonomik dhe deri diku Fakulteti Filozofik komunikimi profesor-student, por edhe vlerësimi gjatë orës është i vështirë”, u shpreh Bytyqi.



VLERËSIMI SISTEMATIK SHMANG AFATET E PARREGULLTA TË PROVIMEVE

“Vlerësimi gradual është më i mirë për shkak se është stimulues, është aktiv gjatë gjithë kohës, është më dinamik për faktin se nuk lejon që studenti vetëm dy javët e fundit, apo muajin e fundit të jetë aktiv dhe aty mandej të tentojë ta përfundojë këtë proces”, theksoi Mala.

Ai konsideron se profesorët e Fakultetit Filozofik janë të gatshëm ta implementojnë në tërësi vlerësim gradual sipas syllabusit.

“Këtu janë dy binarë të zhvillimit të këtij procesi: njëri është vetëdijësimi akademik i profesorëve për këtë proces që është në nivel relativisht të kënaqshëm, mirëpo në anën tjetër është edhe infrastruktura ligjore, e cila në instancën e fundit duhet ta obligojë profesorin t’i çojë këto procese ashtu siç kërkohen”, thotë Mala.

Haxhi Gashi, dekan në Fakultetin Juridik, ka thënë për Preportr se prejse ka ardhur në krye të fakultetit, zbatohet në masë të madhe vlerësimi sistematik që aktualisht përfshin vlerësimin me shkrim, me gojë, konsultime, etj.

“Përveç kësaj, është paraparë të bëhet edhe vlerësimi permanent përmes kollokviumeve, ushtrimeve dhe testeve finale para se të hyhet në provim, pra këto pikë barten në testin final të provimit”, thotë Gashi.

Ai thotë se numri i madh i studentëve paraqet vështirësi, sepse e bën edhe më të vështirë punën, por sipas tij, që nga viti 2015 ka rënie të studentëve të pranuar për 40 për qind në krahasim me vitet paraprake.

“Ne kemi bërë ndarje të grupeve, secili student e ka sallën, orarin dhe kësajsoj kërkojmë të bëhet një shpërndarje sipas orareve dhe jo të grumbullohen të gjithë në një orar të caktuar. Tani do të jetë menaxhimi elektronik përmes SEMS-it, por edhe përmes aparateve elektronike që vendosen në secilën sallë dhe në secilin amfiteatër, ku edhe do të vendosen kartelat për pjesëmarrje të studentit. Në vitin e ardhshëm akademik do të llogaritet në vlerësim edhe pjesëmarrja në ligjërata”, theksoi dekani Gashi.

Sipas tij, metoda e vlerësimit sistematik e rrit cilësinë, sepse e mban në një presion të vazhdueshëm edhe studentin që të jetë aktiv në procesin mësimor dhe të mos kalojë në pasivitet.

“Paraprakisht edhe profesorët e dinë se një kategori e studentëve veçse e kanë arritur notën kaluese apo notën më të mirë të mundshme brenda periudhës së ligjëratave. Mendoj se të gjithë duhet ta zbatojnë këtë metodë dhe jo të bazohen në shtimin e afateve të provimeve”, u shpreh Gashi.

Muhamet Mala, prodekan për kërkime shkencore në Fakultetin Filozofik, thotë se duke marrë parasysh natyrën e lëndëve në këtë fakultet, provimet në disa lëndë mbahen me shkrim dhe me gojë. Ai thotë se nuk e di saktësisht se sa zbatohen syllabuset në aspektin e vlerësimit nga të gjithë profesorët e këtij fakulteti.

“Nuk kemi ndonjë hulumtim real që do të na tregonte se sa po zbatohen syllabuset i cili do të na jepte një shifër të përafërt lidhur me përqindjen se sa respektohet syllabusi”, thotë Mala.

Prodekani Mala i cili është edhe profesor në departamentin e historisë, thotë se vlerësimi gjatë gjithë semestrit në aspektin metodik është më i preferuar dhe do ta lehtësonte punën edhe të profesorëve për arsye se ata tashmë kanë informacione në lidhje me aktivitetin dhe interesin e studentit përkatës me lëndën.

ZBATIM I PJESSHËM I SYLLABUESVE

Dukagjin Pupovci, njohës i fushës së arsimit, thotë se vlerësimi sistematik i studentëve kërkon disa kushte të veçanta siç është për shembull numri adekuat i studentëve për një mësimdhënës, të cilat në shumë fakultete në Kosovë nuk plotësohen.

Ai thotë se nëse janë 200 studentë për një profesor është shumë e logjikshme që një vlerësim i tillë edhe nëse bëhet ndonjëherë në mënyrë periodike me ndonjë test ose me ndonjë mënyrë pak më formale, nuk i jep ndonjë cilësi shtesë procesit të vlerësimit.

“Se sa zbatohet vlerësimi që është i paraparë në syllabus, kjo vërtet varet nga mësimdhënësit pasi që nuk ka ndonjë politikë të përgjithshme në nivel të universitetit e cila do të kontrollonte dhe do të impononte një mënyrë të tillë të vlerësimit”, thotë Pupovci.

Ai thotë se nëse profesori e bën vlerësimin në mënyrë sistematike, ngarkesa e atij profesori është shumë më e madhe se ngarkesa normale të cilën një numër i madh e preferojnë, e cila matet me 45 minutat e orës së mësimit.

“Për fat të keq një numër i konsiderueshëm i profesorëve nuk janë në gjendje ta bëjnë një angazhim të tillë, duke i marrë parasysh kushtet tona që i kemi, sepse atë kohë e shfrytëzojnë më “mirë”, duke punuar në ndonjë institucion tjetër, duke mbajtur orë shtesë e kështu më radhë, të cilat materialisht u konvenojnë më shumë. Këto tregojnë se duhet të ketë një sistem i cili në një mënyrë do ta drejtojë personelin akademik kah ajo që ta bëjnë vlerësimin sistematik të studentëve, e jo kjo t’i lihet vullnetit individual të secilit”, theksoi ai.

Pupovci i cili për disa dekada ka qenë edhe profesor në UP, thotë se shpeshherë syllabueset nuk janë në përputhje me realitetin, pasi që sipas tij, disa syllabuse merren ndonjëherë edhe nga universitetet e tjera dhe profesorët i paraqesin metodat më të mira për të cilat kanë njohuri, e pastaj zbatimi i tyre është çështje tjetër.

“Pra, nuk ekziston një përcjellje sistematike e zbatimit të atyre syllabuseve. Kjo mund të bëhet në radhë të parë përmes vlerësimit të cilin studentët e bëjnë për mësimdhënësin, ku pyetje kyçe duhet të jetë se sa i përmbahen mësimdhënësit syllabuesit, a ka vlerësim sistematik të studentëve dhe cilat janë format. Ekzistojnë edhe forma të tjera ku mësimdhënësit me rastin e zbatimit të vlerësimit sistematik raportojnë në nivel të njësisë së vet organizative dhe aty bëhet njëfarë monitorimi i rregullt i atij sistemi”, u shpreh Pupovci.

Ai thotë se në thelbin e procesit të Bolonjës, përveç sigurimit të jashtëm të cilësisë që e bënë Agjencia e Akreditimit, duhet të ekzistojë në të gjitha institucionet e nivelit të lartë edhe sigurimi i brendshëm i cilësisë.

“Duhet të ekzistojnë persona të cilët e bëjnë monitorimin e këtyre gjerave, të cilët këshillojnë, rekomandojnë në rastet kur ka nevojë që të zbatohen këto metoda”, thotë Pupovci.

“Se sa zbatohet vlerësimi që është i paraparë në syllabus, kjo vërtet varet nga mësimdhënësit pasi që nuk ka ndonjë politikë të përgjithshme në nivel të universitetit e cila do të kontrollonte dhe do të impononte një mënyrë të tillë të vlerësimit”

Dukagjin Pupovci, njohës i fushës së arsimit

PROFESORËT DUHET TË TRAJNOHEN PËR METODAT E VLERËSIMIT DHE TË MËSIMDHËNIES

Prorektori Hysen Bytyqi thotë se njëri nga drejtimet ku rektorati është duke u fokusuar ka të bëjë me format e vlerësimit nga ana e profesorëve. Sipas tij, një pjesë e profesorëve kanë nevojë edhe për trajnime të tilla.

Ai thotë se procesi në institucionet e arsimit të lartë është shumë dinamik dhe metodologjia e vlerësimit dhe e përpilimit të testeve është po ashtu shumë dinamike. Bytyqi thotë se një numër i profesorëve të rinj të cilët vinë prej fushave që nuk kanë pasur metodologji të mësimdhënies apo forma të vlerësimit dhe me një gjë të tillë ballafaqohet për herë të parë, nuk mund ta kryejnë atë punë në mënyrën më të mirë.

“Do të punohet në trajnime për metodologjinë e vlerësimit, pa dashur që ne t’u tregojmë pedagogëve me eksperiencë të jashtëzakonshme se si bëhet testi apo si përpilohen pyetjet e kështu me radhë. Unë konsideroj se ka nevojë të punohet në këtë drejtim dhe ne jemi duke punuar”, thotë Bytyqi.

Në anën tjetër, prodekani Muhamet Mala thotë se iniciativa e rektoratit për t’i implementuar syllabuset është e mirëseardhur. Ai përkrah idenë që të punohet në aspektin metodik me profesorët, e sidomos me ata që janë më të ri. Sipas Malës, ata mund të jenë të mirë në aspektin shkencor, por mund të çalojnë në aspektin metodik, të transmetimit të dijes tek studentët.

“Mendoj se në një të ardhme në rektorat do të parashihet që me rastin e fitimit të gradave akademike të sillen edhe një dëshmi e ndjekjes së një trajnimi ose disa trajnime të profesorëve nga procesi i mësimdhënies, nga metodika, në mënyrë që ai të jetë i kompletuar jo vetëm në fushën shkencore, por edhe në fushën e mësimdhënies”, thotë Mala.



Sipas Statutit të UP-së, për përcaktimin e suksesit akademik do të aplikohen këto metoda:
 -Provimi; -Kolokviumi;
 -Punimi seminarik;
 -Praktika profesionale;
 -Testi praktik gjatë ushtrimeve; -Interpretimi dhe prezantimi i krijimtarisë artistike dhe i punëve të tjera.



STUDENTËT KËRKOJNË VLERËSIM TË VAZHDUESHËM

Se syllabuset nuk po zbatohen në praktikë e thotë edhe Dibran Hoxha nga Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim (ORCA). Sipas tij, në masë të madhe po përdoret metoda e provimit final për të testuar dhe për të vlerësuar studentët.

“Pika 8 e nenit 110 thotë se mënyra e përcaktimit të dijës dhe të dhënies së provimit do të rregullohet me programin mësimor të lëndës – syllabusin. Që me qenë i drejtpërdrejtë kam marrë dy syllabuse nga përvoja ime në studime, ku parashihen mënyrat e vlerësimit, por unë nuk kam parë respektim të këtyre metodave të vlerësimit nga ana e profesorëve. E gjithë metoda e vlerësimit ka qenë e koncentruar në provimin final”, thotë Hoxha.

Një problem bazik që pengon vlerësimin gradual sa i përket performancës së studentëve në ligjërata është fakti se një pjesë e profesorëve shpesh nuk i mbajnë ligjëratat. Një monitorim dhe anketim i realizuar nga ORCA me studentët e fakultetit filozofik, juridik dhe ekonomik tregon se disa profesorë nuk i mbajnë me rregull ligjëratat. Po këto të dhëna tregojnë se në disa raste ligjëratën që do të duhej ta mbante profesori e ka mbajtur asistenti.

“Nga 1177 ligjërata sa janë monitoruar në tri fakultetet e përfshira në hulumtim, 218 apo 18,5 për qind prej tyre nuk janë mbajtur për shkak të mungesës së profesorëve”, thuhet ndër të tjera në raportin monitorues të ORCA-së.

Në vitet e fundit, edhe Zyra Kombëtare e Auditimit ka gjetur se disa profesorë nuk kanë qenë të pranishëm në ligjërata dhe kanë marrë pagesën për orët që s’i kanë mbajtur.

Preportr ka biseduar me disa studentë të fakulteteve të UP-së në lidhje me mënyrën e vlerësimit nga ana e profesorëve, por vetëm disa prej tyre kanë pranuar të flasin para kamerës.

“Vlerësimi periodik është më i mirë për arsye se studentit i mundëson sukses më të madh, mësim permanent, dije praktike, nuk është si provimi përfundimtar, pasi që vlerësimi vetëm përmes këtij provimi na jep rezultat me të dobët”, thotë Admir Krasniqi, student në Fakultetin e Ekonomik.

Valentina Murati, studente në Fakultetin Filozofik, thotë se vetëm disa nga profesorët e përdorin vlerësimin e vazhdueshëm dhe shumica e bëjnë vlerësimin e studentëve përmes provimit final.



Vlerësimi periodik është më i mirë për arsye se studentit i mundëson sukses më të madh, mësim permanent, dije praktike, nuk është si provimi përfundimtar, pasi që vlerësimi vetëm përmes këtij provimi na jep rezultat me të dobët



Admir Krasniqi, student në Fakultetin e Ekonomik.

Preportr

BULETIN

Preportr – Qendra Kosovare për Gazetari Hulomtuese është një projekt i filluar nga Organizata anti-korrupsion në Kosovë – ÇOHU. Projekti ka për qëllim ngritjen dhe mbështetjen e gazetarisë hulomtuese në Kosovë përmes ofrimit të një hapësire alternative për gazetarët entuziastë që të transmetojnë hulumtimet e tyre pa frikën e censurës.

BULETINI REDAKTOHET NGA:

Arton Demhasaj

AUTORËT:

Besnik Boletini, Leonida Molliqaj

DESIGN AND LAYOUT:

envinion

TELEFONI:

038 248 506

E-MAIL:

office@preportr.com.
preportr.cohu.org

Shënim: Organizata Çohu është anëtare e Koalicionit për Integritet dhe Transparencë në Universitet – KITU, mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur – KFOS

Ky hulumtim është pjesë e programit të KITU-së. Pikëpamjet e shprehura në këtë hulumtim janë të Organizatës Çohu! dhe nuk paraqesin medoemos pikëpamjet e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur – KFOS.



Organizata për
Demokraci, Antikorrupsion
dhe Dinjitet, Çohu!



KOALICIONI PËR INTEGRITET DHE
TRANSPARENCE NË UNIVERSITET



Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society